

R A P O R T

**PËR PUNËN E
ENTIT SHTETËROR PËR PRONËSI INDUSTRIALE
PËR VITIN 2011**



Mars, 2012

I STATISTIKA

PATENTA


Aplikime për patenta në vite

Viti	Vendor	Të huaj, faza nacionale			Gjithsej para ESHIP	Caktime		Vendime të lëshuara
		MBP ¹⁾	EEP ²⁾	Para ESHIP		MBP	EEP	
	1	2	3	4	5= 1+4	6	7	9
2003	48	23	363	386	434	87469	3883	105
2004	44	9	399	408	452	38076	4545	102
2005	53	15	368	383	436	3381	4639	373
2006	55	4	403	407	462	3	4879	463
2007	150	13	365	378	528	0	5415	524
2008	34	5	401	406	440	0	5555	328
2009	39	11	372	383	422	0	3785	334
2010	27	1	336	337	364	0	2217	406
2011	37	3	365	368	405	0	880	392
Gjithsej	487	84	3372	3456	3943	128929	35798	3027

¹⁾ MBP – Marrëveshje për bashkëpunim në fushën e patentave

²⁾ EEP - Enti Evropian për Patenta

Aplikime për patenta sipas viteve





Në Entin shtetëror për pronësi industriale të Republikës së Maqedonisë gjatë vitit 2011 janë parashtruar 405 aplikime për patenta prej të cilave 37 nga vendi dhe 368 të huaja. Numri i aplikimeve të dorëzuara në vitin 2011 në raport me vitin 2010 është rritur për 11,3%. Rritja e numrit të aplikimeve të parashtruara në vitin 2011 vjen si pasojë e rritjes si të të njëjtave nga aplikuesit vendor dhe të huaj.

Ky ndryshim është reflektuar edhe në strukturën e aplikimeve të dorëzuara për patenta sipas burimeve në vitin 2011, kështu që, krahasuar me vitin 2010, është arritur rritje e pjesëmarrjes së aplikimeve nga vendi nga 7,4% në 9,1%, dhe në përputhshmëri me të ndryshon edhe struktura tek shtetet prej ku vijnë aplikimet.

Gjatë vitit 2011 në Republikën e Maqedonisë, në raport me numrin e aplikimeve nga vendi, është arritur rritje: numri i aplikimeve vendore për patenta është rritur nga 27 në vitin 2010 në 37 në vitin 2011 ose për 37%, ndërsa pjesëmarrja e tyre në numrin e përgjithshëm të aplikimeve të dorëzuara është rritur nga 7,4% në 9,1%.


Megjithatë, edhe më tej ekziston interesim nga kompanitë e huaja, edhe pse ato dukshëm zvogëlohen, që vërehet nga prania e caktimeve për Republikën e Maqedonisë si vend me interes, sipas PCT, e sidomos përmes Marrëveshjes me EEP.

Aplikime për patenta sipas burimeve në vitin 2010 dhe 2011



Patenta të pranuar sipas MKP në vitin 2011

Struktura e patentave të pranuar sipas MKP është me pjesëmarrje më të madhe në seksionin C (kimi, metalurgji) me 48,7% dhe seksionin A (nevojat aktuale jetësore) me 36,3%, që tregon se interesi për mbrojtje është i lidhur me strukturën e kapaciteteve prodhuese në Republikën e Maqedonisë.



Të dhëna të tjera statistikore për patentat


Përveç kësaj, gjatë vitit 2011, Enti shtetëror për pronësi industriale ka zhvilluar edhe aktivitete të tjera nga fusha e patentave: janë përpunuar 459 kërkesa për njohje të patentave, janë lëshuar 392 vendime për patenta, prej të cilave 364 aplikime nga PE, 26 vendore dhe 2 RST, janë hedhur poshtë 59 kërkesa për njohje të patentave, janë refuzuar 8 kërkesa për njohje të patentës, janë zgjidhur 147 kërkesa për kërkim në bazën e të dhënave.

MARKA TREGTARE

Aplikime për marka tregtare, gjithsej dhe për vite

Viti	Vendor	Aplikime të huaja				Gjithsej sipas rregull. Të Madridit	Gjithsej Të huaja	Gjithsej aplikime	Vendime të lëshuara
		Para ESHIP	Sipas marrëveshjes së Madridit						
			Të reja	Zgjerim Territor.	Prodh. l ef.				
	1	2	3	4	5	6=3+4+5	7=6+2	8=7+1	9
2003	478	515	2490	590	-	3080	3595	4073	535
2004	458	598	2678	487		3165	3763	4221	294
2005	433	617	3659	620		4279	4896	5329	626
2006	494	749	3311	495		3806	4555	5049	1290
2007	618	637	3854	707		4561	5198	5816	979
2008	1276	690	4057	651		4708	5398	6674	1822
2009	898	398	3130	601		3731	4129	5027	1433
2010	944	537	2623	599		3222	3759	4703	783
2011	917	474	2788	600		3488	3962	4906	1616
Gjithsej	6516	5215	28590	5350	0	34040	39255	45798	9378

Aplikime për marka tregtare, gjithsej dhe për vite



Gjatë vitit 2011 në Entin shtetëror për pronësi industriale të Republikës së Maqedonisë kanë arritur gjithsej 4906 aplikime për marka tregtare, prej të cilave 66,7% sipas marrëveshjes së Madridit, ndërsa të tjerat janë dorëzuar në Entin shtetëror. Në strukturën e numrit të përgjithshëm të aplikimeve, 69 % janë të huaja (nga jashtë). Në vitin 2011 janë dorëzuar gjithsej 4906 aplikime për marka tregtare që në raport me vitin paraprak përfaqëson rritje për 4,1%. Kjo rritje i atribuohet fluksit të rritur, para se gjithash të aplikimeve të huaja sipas Marrëveshjes së Madridit.

Para Entit Shtetëror gjatë vitit 2011 janë dorëzuar gjithsej 1391 aplikime dhe në krahasim me vitin paraprak, numri i tyre është rritur për 14,3%. Nga numri i përgjithshëm i aplikimeve, 944 janë nga aplikues vendor, që shënojnë rritje në raport me vitin paraprak për 5,1%, dhe 537 nga aplikues të huaj, që gjithashtu shënojnë rritje prej 34,9% në raport me vitin paraprak.

Sipas marrëveshjes së Madridit, gjatë vitit 2010 janë dorëzuar gjithsej 3222 aplikime për marka tregtare, prej të cilave 2623 janë aplikime të reja dhe 599 zgjerime territoriale. Krahasuar me vitin 2009, numri i aplikimeve sipas kësaj marrëveshje shënon ulje prej 16,2% në raport me aplikimet e reja dhe prej 0,3% në raport me zgjerimet territoriale.

Në periudhën prej vitit 2003 deri në vitin 2011, në Entin shtetëror për pronësi industriale kanë arritur gjithsej 40892 aplikime për marka tregtare, prej të cilave 74,6% sipas Marrëveshjes së Madridit dhe 25,4% të dorëzuara para Entit.

Në strukturën e numrit të përgjithshëm të aplikimeve, 86,3% janë nga jashtë, e vetëm 13,7% janë aplikues vendor.


Aplikime për marka tregtare të dorëzuara në ESHIP

Viti	Vendor	Të huaj	Gjithsej
2003	478	515	993
2004	458	598	1056
2005	433	617	1050
2006	494	749	1243
2007	618	637	1255
2008	1276	690	1966
2009	898	398	1296
2010	944	537	1481
2011	917	474	1391
Gjithsej	9112	5215	11731

Në periudhën e viteve 2003-2011 në Entin shtetëror për pronësi industriale të Republikës së Maqedonisë janë dorëzuar gjithsej 11713 aplikime për marka tregtare, prej të cilave 44,5% janë aplikime për marka tregtare nga jashtë, ndërsa 55,5% janë nga aplikues të vendit dhe të njëjtit shënojnë ulje të konsiderueshme në raport me vitet paraprake, sidomos ato të huaja, ndërsa ulje jo të konsiderueshme shënojnë edhe aplikimet e vendit.

Numri i aplikimeve të dorëzuara për marka tregtare në vitin 2011 është 1391 dhe në krahasim me vitin paraprak është ulur për 7%. Ulje të numrit të aplikimeve për marka tregtare në vitin 2011 është vërejtur edhe tek aplikimet e vendit me 5,1%, si edhe me ato të huaja me 11,7% ulje. Nga ky raport i aplikimeve të dorëzuara rrjedh edhe pjesëmarrja e rritur e aplikimeve të huaja nga 30,7% në vitin 2009 në 36,3% në vitin 2010, ndërsa tek aplikimet në vend pjesëmarrja është ulur nga 69,3% në 63,7%.

Aplikime për marka tregtare sipas klasifikimit të Gicës në vitin 2011



Sipas klasifikimit ndërkombëtar të produkteve dhe shërbimeve (Marrëveshja e Gicës) situata e aplikimeve të dorëzuara për marka tregtare sipas klasave është thuajse e njëjtë krahasuar me atë të vitit paraprak. Kështu, në vitin 2010 më të shpeshtat ishin aplikimet për marka tregtare nga klasat 35, 05, 30, 41, 29 dhe 43, ndërsa në vitin 2011 më së shumti aplikime ishin dorëzuar për klasat 35, 05, 41, 43, 29 dhe 30. Më së shumti aplikime ishin pranuar për produkte të klasës 35 (463, me pjesëmarrje prej 33,3%), në vend të dytë është klasa 05 (217 aplikime, me pjesëmarrje prej 15,6%) dhe në të tretin, klasa 41 (193, me pjesëmarrje prej 13,9%). Vijnë aplikimet për produktet nga klasat 30, 29 dhe 43 (169, 100 dhe 140 respektivisht, me pjesëmarrje përkatëse prej 12,1%, 7,2% dhe 10,1%). Këto të dhëna tregojnë për interesimin gjithnjë e më të madh për mbrojtje të markave tregtare në pjesën e tregtisë me shumicë dhe pakicë dhe në shpalljen, udhëheqjen e punëve, menaxhimin e punëve dhe punë administrative nga klasa 35. Gjithashtu i madh është interesimi për mbrojtjen e produkteve farmaceutike dhe produkteve të tjera për përdorim mjekësor nga klasa 05, që i atribuohet faktit se në Republikën e Maqedonisë ekziston industria farmaceutike. Për t'u shënuar janë edhe aplikimet për marka tregtare nga fusha e produkteve ushqimore me prejardhje bimore për konsum apo konservim, si dhe aditivë të krijuar për përmirësimin e shijes së ushqimit nga klasa 30. Gjithashtu për të shënuar janë edhe aplikimet për marka tregtare nga fusha e klasës 29. E konsiderueshme është edhe pjesëmarrja edhe nga fusha e klasës 43. Nga të gjitha aplikimet e arritura sipas klasave në vitin 2011 mund të vërehet se është e pranishme prirja e dispersionit gjithnjë e më të madh të aplikimeve nga klasa të ndryshme, respektivisht, përkaj gjashtë klasave të cekura më të shpeshta ekzistojnë edhe gjashtë klasa të tjera me rreth njëqind aplikime apo edhe më shumë. Mund të përfundohet se më e rëndësishme është pjesëmarrja e aplikimeve që lidhen me prodhimin dhe tregtimin e produkteve farmaceutike dhe produkteve për nevoja mjekësore, si edhe për prodhimin apo përgatitjen e produkteve ushqimore, duke marrë parasysh se Republika e Maqedonisë ka të zhvilluar industri farmaceutike dhe industriale.

Marka tregtare të pranuar (njohura) sipas viteve

Viti	Vendor	Të huaj	Gjithsej
2003	137	398	535
2004	127	167	294
2005	129	497	626
2006	322	968	1290
2007	278	701	979
2008	620	1202	1822
2009	791	642	1433
2010	944	537	1481
2011	1012	604	1616
Gjithsej	3899	5479	9378

Nga pasqyra e dhënë tabelore për marka të regjistruara tregtare sipas viteve vërehet se numri i tyre ndjeshëm ka rënë në vitin 2004 në krahasim me vitin 2003, ndërsa në dy vitet e ardhshme (2005 dhe 2006) arrin rritje të madhe me mbi 100%, që në vitin 2007 sërish të shënojë ulje në krahasim me vitin 2006, ndërsa në vitin 2008 të shënojë rritje të madhe prej 86,1% krahasuar me vitin 2007 dhe në fund të vitit 2009 shënohet sërish ulje prej 21,4% në raport me vitin 2008. Në vitin 2010 në raport me vitin 2009, numri i markave të pranuar tregtare shënon rritje, ndërsa në vitin 2011 në raport me vitin 2010 kjo rritje është 8,3%.

Marka ndërkombëtare tregtare të regjistruara në Maqedoni

Marka tregtare maqedonase të regjistruara ndërkombëtare në kuadër të Marrëveshjes së Madridit në vitin 2011 në raport me vitin 2010 shënojnë rritje prej 7% në krahasim me vitin paraprak. Në vitin 2011 përmes ESHPI në Organizatën botërore (OMPI) ndërkombëtarisht u regjistruan 17 marka tregtare, ndërsa në vitin 2009 ndërkombëtarisht janë regjistruar 20 marka tregtare. Përsëri lëvizjeve negative të realizuara në vitin 2010, ekziston hapësirë që situata me markat tregtare maqedonase ndërkombëtarisht të regjistruara të përmirësohet, meqenëse duhet sa më shumë të nënvizohet fakti se kompanitë e Maqedonisë ende nuk e kanë kuptuar rëndësinë mbrojtjes ndërkombëtare të markave tregtare dhe faktit se përdorimi i sistemit të Madridit sjell shumë përparësi (çmim më të ulët, një aplikim për më shumë shtete e të ngjashme), në raport me aplikime nëpër shtete.

Të dhëna të tjera statistikore për markat tregtare

Gjatë vitit 2011, Enti shtetëror për pronësi industriale zhvilloi edhe aktivitete të tjera nga fusha e markave tregtare. Respektivisht, janë lëshuar: 104 vendime për vazhdimin e vlefshmërisë së markave tregtare, 300 vendime për ndërprerjen e vlefshmërisë së markave tregtare, 1377 ngarkesa për pagesë të taksave për vendime për marka tregtare, 558 dokumente për marka tregtare, 222 vërtetime dhe certifikata për marka tregtare të paraqitura dhe të regjistruara, 335 rikërkime (reshershë), 245 aplikime për marka tregtare janë hedhur poshtë, 115 vendime për refuzimin e aplikimeve për marka tregtare, 793 ngarkesa për pagesën e shpenzimeve për publikimin e aplikimit të markës tregtare, 742 caktime të datave për dorëzimin e


aplikacionit, 30 vendime për kthim në gjendjen e mëparshme, ndërsa për 19 aplikime për marka tregtare është ndërprerë procedura.

DIZAJNI INDUSTRIAL

Aplikime për dizajn industrial, gjithsej dhe për vite

Viti	Vendore	Aplikime të huaja		Gjithsej të huaja	Gjithsej aplikime	Vendime të lëshuara
		Para ESHPI	Sipas marrëveshjes së Hagës			
	1	2	3	4=2+3	5=4+1	6
2003	45	26	582	608	653	621
2004	31	16	566	582	613	577
2005	47	13	737	750	797	798
2006	32	3	773	776	808	815
2007	39	13	979	992	1031	1016
2008	21	11	1022	1033	1054	1064
2009	28	17	729	746	774	759
2010	25	10	715	735	760	746
2011	45	16	726	742	803	758
Gjithsej	278	109	6103	6242	6490	7154

Aplikime për dizajn industrial, gjithsej dhe për vite



Gjatë vitit 2011 deri te Enti shtetëror për pronësi industriale janë dorëzuar 803 aplikime për dizajn industrial. Numri i përgjithshëm i aplikimeve për dizajn industrial të dorëzuara në vitin 2011 krahasuar me vitin paraprak është rritur për 9,7%. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të aplikimeve të dorëzuara për dizajn industrial deri te Enti shtetëror, aplikimet vendore në vitin 2011 në raport me vitin paraprak shënojnë rritje prej 28,06%, ndërsa ato të huaja rritje prej 60%. Nga numri i përgjithshëm i aplikimeve të dorëzuara, 61 janë dorëzuar në Ent, ndërsa 726 përmes Marrëveshjes së Hagës për regjistrim ndërkombëtar të dizajnit industrial, prej të cilave 301 janë të reja, ndërsa 425 kanë të bëjnë me dizajn industrial për të cilat është vazhduar vlefshmëria për territorin e Republikës së Maqedonisë. Karakteristike për dizajnet është ajo që me një aplikim për njohje të së drejtës të dizajnit industrial, mund të kërkohej mbrojtje e më shumë dizajneve të produkteve (aplikim i shumëfishtë), ndërkohë që të gjithë dizajnet nga aplikimi duhet të jenë të parapara për t'u zbatuar për produkte të klasifikuara në të njëjtën klasë sipas klasifikimit ndërkombëtar (Klasifikimi Lokarno). Sipas kësaj, nga 61 aplikimet e dorëzuara në Ent, shumica janë të shumëfishta, me gjithsej 144 dizajne.

Aplikime për dizajn industrial të dorëzuara në ESHPI

Viti	Vendore	Të huaja	Gjithsej
2003	45	26	71
2004	31	16	47
2005	47	13	60
2006	32	3	35
2007	39	13	52
2008	21	11	32
2009	28	17	45
2010	35	10	45
2011	45	16	61
Gjithsej	323	125	448

Në periudhën midis viteve 2003-2011 në Entin shtetëror për pronësi industriale të Republikës së Maqedonisë janë dorëzuar 448 aplikime për dizajn industrial, prej të cilave 27,9% janë aplikime për dizajn industrial nga persona të huaj fizik e juridik.

Numri i aplikimeve të dorëzuara për dizajn industrial në vitin 2011 është 61 dhe në krahasim me vitin paraprak është rritur, respektivisht ka rritje prej 35,5%. Rritje e numrit të aplikimeve për dizajn industrial në vitin 2011 është vërejtur tek aplikuesit e vendit për 28,6%, ndërsa tek të huajt rritja është për 60%. Nga ky raport i aplikimeve të dorëzuara për dizajn industrial rrjedh edhe pjesëmarrja e rritur e aplikimeve nga vendi nga 25% në 2010 në 28,6% në vitin 2011, ndërsa tek aplikuesit e huaj nga 37,8% në 60%.

Dizajne industriale të pranuar (njohura), gjithsej dhe sipas viteve


Viti	Vendor	Të huaj	Ndërkombëtar	Gjithsej
2003	28	11	582	621
2004	8	3	566	577
2005	23	38	737	798
2006	32	10	773	815
2007	34	3	979	1016
2008	26	16	1022	1064
2009	23	7	729	759
2010	24	7	715	746
2011	27	9	726	762
Gjithsej	225	104	6100	7158

Në vitin 2011 në Ent janë sjellë 36 vendime për njohjen e së drejtës për pronësi industriale, prej të cilave 27 nga vendi, 9 të huaja, të njohura para Entit shtetëror i të huaja ndërkombëtarisht të njohura për territorin e Republikës së Maqedonisë, 726.

Numri i përgjithshëm i dizajneve industriale të pranuar (njohura) në vitin e cekur është rritur për 2,1%, që është rezultat i numrit të rritur të dizajneve industriale të njohura në vend dhe ndërkombëtarisht.


Përndryshe, këtu duhet të cekim se në numrin e përgjithshëm të aplikimeve ndërkombëtarisht të dorëzuara dhe regjistruara sipas marrëveshjes së Hagës, prej tyre 1700 janë të evidentuara si një apo si aplikim i shumëfishtë për dizajn industrial.

Dizajne industriale të pranuar sipas burimeve në vitin 2011



Shikuar nga burimet prej numrit të përgjithshëm të dizajneve industriale që vlejné për territorin e Republikës së Maqedonisë, pjesëmarrje më të madhe në vitin 2011 ka Zvicra me 325 dizajne të regjistruara industriale apo shprehur në përqindje 42,7%. Më pas vijnë: Gjermani me 154 apo 20,2%, Franca me 66 dizajne të regjistruara industriale apo 8,7%. Maqedonia me 61 apo në përqindje prej 8,0%, Holanda me 30 apo në përqindje 3,9% dhe Turqia me 18 apo 2,4% e kështu me radhë.

Aplikime për dizajn industrial sipas Klasifikimit ndërkombëtar për dizajn industrial (Klasifikimi Lokarno)



Nga grafiku i mësipërm vërehet se Enti shtetëror për pronësi industriale i Republikës së Maqedonisë, në vitin 2011, me pjesëmarrje prej 42,1% në aspektin strukturor më të përfaqësuar janë dizajnet e pranuar industriale nga klasa 10 dhe dizajnet industriale nga klasa 9, me pjesëmarrje prej 12,3%. Dizajnet industriale nga klasa 10 kanë të bëjnë me produkte të orëve dhe instrumente të tjera matëse, kontroll dhe sinjalizim, ndërsa dizajnet industriale nga klasa 9 kanë të bëjnë me ambalazhin dhe enëve (pajisjeve) për transport apo për bartje të mallrave, që i atribuohet zhvillimit të rritur të prodhimit të ambalazhit, dhe me këtë edhe të konkurrencës së rritur në treg. Viojnë 32 dizajnet industriale nga klasa 12 me pjesëmarrje prej 8,3%, ndërsa kanë të bëjnë me mjetet e transportit dhe tërheqjes së ngarkesave. Më pas vijnë 26 dizajne industriale nga klasa 23 me pjesëmarrje prej 6,2% dhe 10 dizajne industriale nga klasa 26 me pjesëmarrje prej 5,9% dhe 28 dizajne industriale nga klasa 14 me pjesëmarrje prej 7,4%. Në grafikë janë paraqitur edhe 98 dizajne industriale nga të gjitha klasat tjera me pjesëmarrje prej 17,8%.

Të dhëna të tjera statistikore për dizajnet industriale

Gjatë vitit 2011, Enti shtetëror për pronësi industriale ka zhvilluar edhe aktivitete të tjera në fushën e dizajnit industrial, respektivisht janë hedhur poshtë 8 aplikime për dizajn industrial, janë refuzuar 3 aplikime për dizajn industrial, janë përgatitur 15 vendime për ndryshime, janë lëshuar 34 dokumente (leje), janë kryer 20 rikërkime (reshershë), është ndërprerë procedura për 3 aplikime, janë lëshuar 3 vendime në bazë të propozimit për shpallje të vendimeve të pavlefshme, 61 njoftime për datë të caktuar për aplikime, 51 ngarkesa për pagesën e shpenzimeve për shpalljen e aplikimit dhe 20 vendime për vazhdimin e vlefshmërisë së dizajneve industriale.

II LEGJISLACIONI

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pronësi industriale

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë solli Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pronësi industriale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/11). Ndryshimet janë në drejtim të harmonizimit horizontal të Ligjit për pronësi industriale me Ligjin për cilësi të produkteve bujqësore, me çka përcaktohet mbrojtja e emërtimeve gjeografike që kanë të bëjnë me produktet bujqësore. Një nga ndryshimet më të rëndësishme që parashihet me Ligjin është dhënia e mundësisë që inspektorati shtetëror i tregut gjatë realizimit të mbikëqyrjes në raport me qarkullimin e të drejtave të mbrojtura nga pronësia industriale menjëherë të konfiskoj produktet me të cilat është kryer shkelja e së drejtës së mbrojtur të pronësisë industriale dhe t'i dorëzojnë gjykatën përkatëse. Gjithashtu me Ligjin ofrohet mundësia për zgjidhje para inicimit të procedurës kundërvajtëse.

Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për mbrojtje të topografisë së qarqeve të integruara

Është sjellë Ligji për plotësime të Ligjit për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2011) me qëllim të inkorporimit të institutit "heshtja është miratim", që përfaqëson harmonizim horizontal me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative. Në bazë të plotësimeve në Ligj është sjellë edhe Rregullore për formën dhe përmbajtjen e kërkesës për mosdhënie të vendimit për njohjen e së drejtës për topografi të qarqeve të integruara, respektivisht vendimit për refuzimin e kërkesës për njohjen e së drejtës dhe regjistrimit në regjistër ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/2011).

Marrëveshje ndërkombëtare

Me qëllim lehtësimin e procedurës për njohjen e patentave, Kuvendi solli **Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për zbatimin e nenit 65 të Konventës evropiane për patenta – Marrëveshja e Londrës** ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 132/11) me të cilin përmes lehtësimit të regjimit të përkthimit, dukshëm ulen shpenzimet për përkthim të patentave evropiane. Me regjimin e ri gjuhësor, kërkesat për patenta gjithmonë janë në dispozicion në gjuhën zyrtare të shtetit në të cilin patenta evropiane është e regjistruar, derisa përkthimi i shkresave të patentës nuk është i nevojshëm (përveç në rast të kontestit në lidhje me patentën evropiane).

III BASHKËPUNIMI BILATERAL

Bashkëpunimi me shtete tjera në fushën e mbrojtjes së pronësisë industriale

- Tre seminare me temë "Marka tregtare – një nga parakushtet për suksesin e kompanive në treg", organizuar në kuadër të Projektit të UE-së "Mbështetja për entet e patentave", u mbajtën nga 22 deri më 24 mars, në Kosovë.
- Konferencë nënregjionale për zbatimin dhe komercializim të së drejtës së pronësisë industriale – përforcimi i kapaciteteve, u mbajt më 12 dhe 13 prill, në Beograd, R. e Serbisë.
- Pjesëmarrje në Ekspozitën e 31-të ndërkombëtare të shpikjeve, teknologjive të reja dhe dizajneve industriale "Inovacionet (shpikjet) Beograd 2011" u mbajt nga 23 deri më 27 maj në Beograd;
- Trajnim me temë "Institucionet evropiane dhe procesi i vendimmarrjes" në kuadër të bashkëpunimit bilateral midis Republikës së Maqedonisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë, u mbajt nga 13 deri më 17 qershor, në Shkup;

- Takimi i Grupit teknik për të drejtat e Pronësisë Industriale të iniciativës veneciane për bashkëpunim, me temë “Bashkëpunimi i administratave doganore të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë me institucionet tjera nacionale të përfshira në mbrojtjen e së drejtave të pronësisë industriale”, që u mbajt më 5 dhe 6 korrik, në Shkup;
- Seminar me temë “Marka tregtare – nevojë apo mundësi”, në organizim të Entit për shpikje dhe marka tregtare të Rumanisë, u mbajt nga 24 deri më 26 gusht, në Venus, Rumani.

IV BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi me Organizatën botërore për pronësi industriale

Sesioni i dyzet e nëntë i takimeve të Kuvendit të vendeve anëtare të Organizatës botërore për pronësi industriale u mbajt në Gjenevë në periudhën prej 26 shtator deri më 5 tetor të vitit 2011. Enti shtetëror për pronësi industriale e përfaqësonte Republikën e Maqedonisë në punën e unionit të Madridit dhe Unionit të marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e patentave.

Drejtori gjeneral i Organizatës në fjalimin e tij në Kuvend shprehu kënaqësi të veçantë nga rezultatet e arritura në fushën e forcimit të sistemeve informative të shteteve, duke theksuar se projekte të tilla janë realizuar në 50 shtete, e më shumë se 40 shtete presin realizimin e projekteve të këtij lloji. Ai me kënaqësi paralajmëroi konferencën e ardhshme diplomatike për sjelljen e Marrëveshjes ndërkombëtare me të cilën do të rregullohen mbrojtja e krijimeve audio-vizuele për personat me shikim të dëmtuar. Ai i nxiti shtetet në krijimin e klimës pozitive për investime në kërkim dhe zhvillim që do të çojë drejt ekonomisë konkurruese dhe ceku shembullin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që investojnë 1,3 trilion dollarë në nivel vjetor për këto qëllime.

Në këtë sesion të Kuvendit u promovua ndërtesa e re dhe salla e konferencave që ishte në ndërtim gjatë tre viteve të kaluara.

Në margjinat e Kuvendit, delegacioni i Entit realizoi sërë takimesh me persona përgjegjës në Organizatë që administrojnë marrëveshjet ndërkombëtare nga fusha e pronësisë industriale që Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar.

Takim i rëndësishëm u realizua me personi përgjegjës për bashkëpunim me Entin ku u përcaktuan fushat e bashkëpunimit për vitin 2012 dhe 2013. Theks i veçantë iu vë edukimit të të punësuarve në Ent, seminare dhe punëtori për target grupe të ndryshme që kanë për qëllim përfundimin e kapaciteteve për menaxhimin e pronësisë industriale në ekonominë e vendit si edhe të projekteve që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe mbindërtimin e sistemeve ekzistuese të teknologjisë informative në funksion të realizimit efikas të procedurës administrative të Entit dhe shpërndarjen e informacioneve në lidhje me të drejtat e paraqitura dhe të mbrojtura të pronësisë industriale.

Bashkëpunimi me organet dhe trupat e Organizatës botërore për pronësi industriale

- Sesioni i 43-të i Komitetit të ekspertëve të Unionit të Marrëveshjes së Strazburgut për klasifikimin ndërkombëtar të patentave u mbajt nga 14 deri më 18 shkurt, në Gjenevë, Zvicër;
- Komiteti për njohuri tradicionale dhe burime gjenetike u mbajt nga 21 shkurti deri më 4 mars të vitit 2011 në Gjenevë, Zvicër;
- Komiteti markat tregtare, dizajnet industriale dhe emërtimet gjeografike u mbajt nga 28 marsi deri më 1 prill, në Gjenevë, Zvicër;
- Takim i Grupit punues për zhvillim të legjisllacionit të Sistemit të Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të dizajneve industriale u mbajt nga 30 maj deri më 1 qershor, në Gjenevë, Zvicër;
-

- "Sesioni i 19-të i Komitetit ndërqeveritar për pronësi industriale për burime gjenetike, njohuri tradicionale dhe folklor" u mbajt nga **18 deri më 22 korrik**, në Gjenevë, Zvicër, në Organizatën botërore për pronësi industriale.
- Sesioni i 26-të i Komitetit për marka tregtare, dizajn industrial dhe emërtime gjeografike u mbajt nga **24 deri më 28 tetor**, në Gjenevë, Zvicër;
- Komiteti i përhershëm për të drejtat e patentave, organizuar nga Organizata botërore për pronësi industriale u mbajt nga **5 deri më 9 dhjetor**, në Gjenevë, Zvicër.
- Qëndrim studimor në Organizatën botërore për pronësi industriale për zhvillimin e tanishëm dhe të ardhshëm të Sistemit të Lisbonës të regjistrimit ndërkombëtar të emërtimeve gjeografike në Republikën e Maqedonisë, në periudhë nga **12 deri më 16 dhjetor**, në Gjenevë, Zvicër.

Seminar në bashkëpunim me Organizatën Botërore për Pronësi Industriale

ESHPI në bashkëpunim me Organizatën botërore për pronësi industriale organizoi seminar me temë: "Transferi i teknologjive", me qëllim që të nxisë subjektet e ekonomike në shtet të arrijnë konkurrueshmëri në tregje përmes përdorimit të mekanizmave të transferit të teknologjive si parakusht në sistemin e ndërtimit të ekonomisë të bazuar në dije.

Bashkëpunimi me Organizatën Evropiane për Patenta

Enti shtetëror për pronësi industriale mori pjesë në punimet e trupave të Organizatës evropiane për patenta. Takime të rregullta të Këshillit Administrues, Komitetit për Buxhet dhe Financa, Komitetit për të drejtat e patentave dhe Komitetit për bashkëpunim teknik u ndoqën nga përfaqësues të emëruar nga Enti.

Aktivitetet në planin bilateral u zhvilluan në kuadër të kornizave të përcaktuara të bashkëpunimit të dhëna në Planin nacional aksional (të veprimit).

Pjesa operative përfshiu realizimin e katër lloj seminaresh prej ku dolën tre publikime të shtypura të dedikuara për afaristët, studentët dhe përfaqësuesit e së drejtave të pronësisë industriale.

Në kuadër të bashkëpunimit vend të rëndësishëm në vitet e fundit iu dha forcimit të vetëdijes për mbrojtjen dhe rëndësinë e së drejtës së pronësisë industriale si mjet për ngritjen e konkurrencës së produkteve dhe shërbimeve në industrinë e vendit.

Bashkëpunimi me Akademinë Evropiane për Patenta

Në kuadër të bashkëpunimit me OEP, përmes Akademisë evropiane për patenta, përfaqësues të ESHPI morën pjesë në:

- Seminar me temë "IP4inno – Pronësia industriale dhe inovacionet e vendeve anëtare", nga **9 deri më 11 shkurt**, në organizim të Akademisë evropiane për patenta, në Vjenë, Austri;
- Seminar me temë "Praktika e rikërkimit dhe testimit në nanoteknologji dhe teknologji të gjelbërta", nga 23 deri 27 maj, në Hagë, Holandë;
- Seminar me temë "Zbatimi i nenit 39 të Konventës Evropiane për patenta – taksa për mbajtjen e së drejtës për patentë", që u mbajt më **9 dhe 10 qershor**, në Vjenë, Austri.
- Punëtori me temë "Përkthim mekanik", që u mbajt më 12 dhjetor, në Vjenë, Austri.

- Seminar me temë "Këmbimi i të dhënave nga regjistri i patentave", në organizim të Entit evropian për patenta, më 14 korrik 2011, në Vjenë, Austri.
- Enti shtetëror për pronësi industriale mori pjesë në punimet e Konferencës "PATLIB 2011" në organizim të Organizatës evropiane për patenta – OEP, që u mbajt nga 23 deri 25 maj të vitit 2011 në Hagë, Holandë.

Bashkëpunimi me Organizatën Evropiane për Patenta në realizimin e Planit Aksional

Në pajtueshmëri me Planin aksional për bashkëpunim bilateral me OEP gjatë vitit 2011 janë realizuar më shumë aktivitete:

Janë botuar katër publikime:

- "Forum ndërkombëtar për pronësi industriale – përmbledhje punimesh",
- "Pronësia intelektuale në ekonomi",
- "Maqedonia – harmonizimi me të drejtën e UE-së dhe me Konventën Evropiane të Patentave" dhe
- "Roli i përfaqësuesve në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale".

Janë mbajtur katër seminare me temë:

- "Zhvillimi i pronësisë intelektuale në Republikën e Maqedonisë me theks të veçantë mbi harmonizimin e legjislacionit dhe Konventës Evropiane të Patentave", në universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup për studentët e studimeve të magjistraturës nga Fakulteti Juridik dhe Ekonomik dhe të Universitetit Shtetëror të Tetovës për studentët e studimeve të magjistraturës nga Fakulteti Juridik dhe Ekonomik;
- "Pronësia intelektuale dhe ekonomia", dedikuar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndërmarrësit dhe menaxherët e bizneseve;
- "Roli i përfaqësuesve në sistemin e pronësisë intelektuale".

V. PJESEMARRJE NË KONFERENCA, KOMITETE, SEMINARE, TRAJNIME

Përfaqësues të ESHPI morën pjesë në punimet e trupave të WIPO dhe OEP, në trajnime, ekspozita dhe ngjarje të tjera, respektivisht në:

- Aftësim profesional në Qendrën për studime ndërkombëtare për pronësi intelektuale në Universitetin e Strasburgut, në kuadër të Projektit Tempus "Studime regjionale pasdiplomike mbi pronësinë intelektuale" në periudhën prej 26 prillit deri më 1 maj, në Strasburg, Francë;
- Trajnim me temë "Politika industriale e konkurrencës" në organizim të Ministrisë së ekonomisë, që u mbajt nga 18 deri më 20 maj, në Shkup;
- Manifestimi "Çmimet evropiane për shpikje" në organizim të OEP dhe KE u mbajt më 19 maj në Mynih, Gjermani;
- "Takimi i pestë vjetor për bashkëpunim me vendet anëtare" në organizim të OEP u mbajt më 14 dhe 15 qershor, në Bratislavë, Sllovakia;
- Ekspozita ndërkombëtare për shpikje – IENA 2011 u mbajt nga 26 deri 30 tetor në Nirnberg, Gjermani;
- Takim pune me Drejtorinë për vendet e Evropës dhe Azisë për shqyrtimin e planit bilateral për bashkëpunim me Organizatën botërore për pronësi industriale për vitin 2012 u mbajt nga 19 deri 23 dhjetor.

- Enti shtetëror për pronësi industriale mori pjesë në punimet e Kongresit të 6-të botëror të luftës kundër falsifikimit dhe piraterisë, që u mbajt më **2 dhe 3 shkurt 2011** në Paris, Francë.
- Takimi i 40-të i Komitetit për të drejtat e patentave u mbajt më 28 nëntor, në Mynih. Temë e takimit ishin SPLH – ndodhitë e kohëve të fundit në lidhje me karakteristikat kryesore të ligjeve evropiane, japoneze dhe amerikane për patentat apo studime krahasuese të grupit “Tegernsee Experts” dhe hapat e ardhshëm të SPLH. Në takim gjithashtu u diskutua edhe për vendimin e GJE për përjashtimin e patentave të shpikjeve që kanë të bëjnë me përdorimin e embrioneve njerëzore për qëllime industriale apo komerciale.

VI STRATEGJIA PËR PRONËSI INDUSTRIALE

Strategjia për pronësi intelektuale e Republikës së Maqedonisë (2009-2012) dhe plani aksional për zbatimin e saj

Në bazë të kreut VIII të Strategjisë për pronësi intelektuale 2009-2012, Enti shtetëror për pronësi industriale është institucioni kompetent për koordinimin e përgjithshëm të zbatimit të Strategjisë.

Në kuadër të masave që përmbahen në Strategjinë për pronësi intelektuale (2009-2012), në vitin 2011 është përpiluar dhe miratuar Informacioni për realizimin e aktiviteteve të Strategjisë për pronësi intelektuale në përputhje me Planin aksional. Vlerësim i përgjithshëm është se numri më i madh i aktiviteteve të parapara janë realizuar.

Nënkomiteti

Takimi i shtatë i Nënkomitetit për treg të brendshëm dhe konkurrencë midis Republikës së Maqedonisë dhe Unionit Evropian, u mbajt më **22 dhe 23 mars të vitit 2011** në Bruksel. Në takim, përfaqësuesit e Republikës së Maqedonisë, respektivisht institucionet përgjegjëse, prezantuan progresin në këtë fushë.

Komisioni Evropian përshëndeti sjelljen e Ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Lisbonës për mbrojtjen e shenjave të prejdardhjes dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtarë, ndryshimet e Ligjit për pronësi industriale dhe aktivitetet për ngritjen e vetëdijes publike, progresin në raport me zbatueshmërinë, bashkëpunimin midis institucioneve, numrit të rritur të procedurave të ndërmarra për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe përgatitjen e Metodologjisë për ndjekjen statistikore dhe përpunimit statistikor të të dhënave për zbatimin e së drejtave të pronësisë intelektuale.

Komisioni evropian informoi për ndodhitë më të reja në kuadër të Unionit Evropian në raport me markat tregtare dhe patentat.

Komiteti për stabilizim dhe asociim

Më **19 tetor 2011** u mbajt Komiteti i tetë për stabilizim dhe asociim. Në lidhje me përgatitjet e Raportit të këtij komiteti, Enti në mënyrë aktive ka bashkëpunuar me institucionet e kyçura në punimet e grupit punues për Të drejtat e pronësisë intelektuale.

Në takim u prezantua progresi në fushën e së drejtave të pronësisë intelektuale. Komisioni evropian përshëndeti sjelljen e Ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Londrës për zbatimin e nenit të Konventës Evropiane për Patenta dhe organizimin e fushatave mediatike për ngritjen e vetëdijes publike për rëndësinë e të drejtave të pronësisë intelektuale. Komisioni vuri në dukje obligimin e ndërmarrë nga Marrëveshja për stabilizim dhe asociim për sigurimin e shkallës së njëjtë të të drejtave të pronësisë intelektuale me atë të Unionit Evropian.

VII TRUPI KOORDINUES

Bartës kryesor i aktiviteteve në luftën kundër piraterisë dhe produkteve të falsifikuara dhe aktiviteteve të ndërmarra lidhur me to ishte **Trupi koordinues për pronësi intelektuale (TKPI)**. TKPI realizon bashkëpunim për çështje që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e tregut dhe zbaton mbrojtjen e së drejtave të pronësisë intelektuale, identifikon probleme të pronësisë intelektuale, propozon zgjidhje, ndërmerr aktivitete që kanë të bëjnë me krijimin e politikave adekuate për mbrojtjen e pronësisë industriale dhe mbrojtjen e të drejtave të autorëve dhe të drejtave të ngjashme dhe drejtpërdrejt merr pjesë në aksionet e koordinuara me përfaqësues të shërbimeve kompetente inspektuese për zbatimin e rregullave nga fusha e pronësisë intelektuale, sipas planit mujor aksional të përcaktuar, për çka rregullisht dorëzon informacione deri tek Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Në përputhje me Programin operativ për luftë kundër piraterisë dhe falsifikimit të sjellë në shkurt të vitit 2010, Trupi koordinues për pronësi intelektuale nga 01.01.2011 deri më 31.12.2011 ka realizuar gjithsej dymbëdhjetë aksione të koordinuara. Në këto aksione janë konfiskuar gjithsej 2746 objekte me të cilat shkelen të drejtat autoriale dhe të drejtat e ngjashme dhe 2056 objekte me të cilat shkelen të drejtat e pronësisë industriale.

Janë dorëzuar 31 parashtrës për iniciimin e procedurave penale para organeve kompetente, 16 kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, është propozuar 1 procedurë për zgjidhje, janë shqiptuar 3 dënime mandatare, dhe janë lëshuar gjithsej 50 urdhër pagesa për pagesën e gjobave.

TKPI, në bashkëpunim me Agjencinë për menaxhim me pronë të konfiskuar dhe Ministrinë e drejtësisë, ka realizuar dy aksione publike për shkatërrimin e objekteve të konfiskuara pas përfundimit të procedurave gjyqësore, **më 26 prill dhe 10 dhjetor të vitit 2011**. Në këto dy aksione publike janë shkatërruar 38.648 produkte me të cilat janë shkelur të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme, 3084 pako cigaresh dhe 80 litra alkool. Aksionet u përcollën nga mediat.

Në pajtim me Programin operativ për luftë kundër piraterisë dhe falsifikimit, Strategjia për pronësi industriale 2009 – 2012 dhe Programin për punë në Entin shtetëror për pronësi industriale për vitin 2011, Trupi koordinues për pronësi industriale filloi me realizimin e aktiviteteve promovuese për forcimin e vetëdijes për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, edhe atë, para se gjithash, në drejtim të efekteve që ajo i ka mbi ekonominë e vendit, forcimin e konkurrencës në ndërmarrjet e vendit, tërheqjen e investimeve të huaja dhe si mjet për krijimin e vendeve të reja të punës dhe uljen e papunësisë. Gjatë viti 2011 janë organizuar dy tribuna publike me karakter edukativ në Kumanovë dhe Shkup për më shumë se 100 pjesëmarrës. Temat e tribunave ishin mbrojtja dhe zbatimi i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale. Mbajtja e tribunave u mbulua me mjete të parapara për informim publik. Përfaqësuesit e Trupit koordinues për pronësi intelektuale morën pjesë në 3 konferenca, 2 seminare dhe 1 punëtori.

XIII AKTIVITETE PËR NGRITJEN E VETËDIJES PUBLIKE

Duke pasur rëndësinë e ngritjes së vetëdijes publike për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, ESHPI ndërmori aktivitete të rregullta lidhur me forcimin e vetëdijes publike: 4 ligjërata për 80 studentë të Fakultetit juridik "Justiniani i Parë" dhe trajnim dyditor për studentët e ESHPI; mbështetje dhe pjesëmarrje në dy manifestime dhe në tre ekspozita në drejtim të stimulimit dhe afirmimit të shpikjeve (zbulimeve); shënimin e Ditës botërore të pronësisë intelektuale përmes promovimit të librit "Masa për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në vendet e Ballkanit Perëndimor", shpalljen e mesazhit të drejtorit gjeneral të OBPI në ueb faqen e ESHPI dhe përmes mjeteve të informimit publik, realizimin e aksionit për shkatërrimin e produkteve të konfiskuara nga Trupi koordinues për pronësi industriale (TKPI) dhe pjesëmarrje në Konferencën për pronësi intelektuale.

Në ekspozitën e 31-të ndërkombëtare për shpikje, avancime teknike, produkte të reja dhe krijime të rinjve **MAKINOVA-EKONOVA 2011**, ESHPI përmes përfaqësuesve të tyre, anëtarëve të komisionit ndërkombëtar vlerësues, ndau çmimet për patenta të paraqitur apo të mbrojtur për novator të ri.

Me qëllim të promovimit të inovacioneve të Maqedonisë në korniza ndërkombëtare, në **Ekspozitën Ndërkombëtare të ideve, shpikjeve, produkteve të reja – IENA 2011**, u prezantuan pesë shpikje të novatorëve nga Maqedonia të cilëve iu ndanë medalje e argjendte dhe e bronzte nga juria profesionale ndërkombëtare dhe një numër të madh të çmimeve speciale nga asociacionet dhe shoqatat nga fusha e inovacioneve. ESHPI për pjesëmarrjen e tij dhe kontributin në promovimin e shpikjeve për herë të dytë mori diplomë nga Enti për patenta i Turqisë. Më 22 dhjetor u mbajt manifestimi tradicional **Patenta e vitit 2011**.

Dita botërore për pronësi intelektuale 2011

Në vitin 2011, Dita botërore për pronësi intelektuale, 26 prill iu kushtua rolit të dizajnit në treg, në shoqëri dhe në formësimin e inovacioneve në të ardhmen. ESHPI në përputhje me shpirtin e mesazhit të drejtorit gjeneral të Organizatës botërore për pronësi industriale, e shënoi ditën me takime me përfaqësuesit e pronësisë industriale, inovatorët dhe bashkëpunëtorët tjerë në zbatimin e mbrojtjes së pronësisë industriale.

Gjithashtu, Trupi koordinues për pronësi intelektuale realizoi aksionin për shkatërrimin publik të produkteve të konfiskuara.

Patenta e vitit 2011

Tradicionalisht, për të tetëmbëdhjetën herë më 26 dhjetor u organizua manifestimi Patenta e vitit 2011, ku u ndanë çmimet për shpikësit më të suksesshëm që morën pjesë në ekspozitat ndërkombëtare të ideve, shpikjeve dhe produkteve të reja – IENA 2011.

Në manifestim ishin të pranishëm inovatorët nga biznesi dhe fakultetet, një numër i madh i përfaqësuesve dhe mysafirë të tjerë. Të pranishmëve iu drejtua zëvendës drejtori i ESHPI, zt. Mite Kostov dhe më pas në mënyrë solemne u ndau çmimin “Patenta e vitit 2011” inovatorëve: Blagoja Samakoski, Zlatko Sokoloski, Gari Manevski dhe Samoil Samak për shpikjen – “Mekanizmi për prerje automatike dhe vendosjen e fibrave plotësuese me rrëshirë”. Shpikja është projektuar dhe realizuar nga firma “TEKON” shpk nga Prilepi.

Me rastin e manifestimit Patenta e vitit 2011 dhe manifestimit jubilar të 20 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë për aktivitetin afatgjatë inovues dhe koordinimin e bashkëpunimit midis ESHPI dhe SPATUM iu nda pllakatë Kola Asenovit nga SPATUM të Teknika popullore e Maqedonisë.

Me rastin e manifestimit Patenta e vitit 2011 dhe manifestimit jubilar të 20 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë për për aktivitetin afatgjatë rinovues, si edhe për patentën ndërkombëtare të mbrojtur në territor më të gjerë në më shumë vende nga Evropa, Azia dhe Amerika iu nda pllakatë inxhi. dipl. Vasil Argirovski.

IENA 2011

Ekspozita ndërkombëtare e ideve, shpikjeve dhe produkteve të reja – IENA 2011 u mbajt nga **27 deri më 30 tetor të vitit 2011** në Nirnberg të Gjermanisë. Në ekspozitë morën pjesë edhe përfaqësues nga Republika e Maqedonisë me qëllim promovimi të shpikjeve të Maqedonisë në suaza ndërkombëtare. Në ekspozitë u prezantuan 5 shpikje të inovatorëve të Maqedonisë.

Juria profesionale ndau çmimet në vijim:

Aplikuesit të shpikjes: “TEKON” shpk dhe shpikësve Blagoja Samakoski, Zlatko Sokoloski, Gari Manevski dhe Samoil Samak për shpikjen – “Mekanizmi për prerje automatike dhe vendosjen e fibrave plotësuese me rrëshirë” u ndanë çmimet në vijim:

- **MEDALJE E ARTË** me diplomë nga Ministria e arsimit, hulumtimeve, rinisë dhe sportit të Republikës së Rumanisë
- **Medalje e bronzte** nga juria profesionale e “IENA 2011”;

- **Medalje e artë dhe diplomë** nga shoqata e Asociacionit për bashkëpunim shkencor dhe teknologjik të Ruisisë;
- **Çmim special** nga Shoqata për promovimin e inovacioneve të Republikës së Koresë.

Aplikuesit për shpikjen: "AC DC" dhe shpikësit Ivan Popoviç dhe Vangel Dimanovski për shpikjen "AC DC koncept – protektor (mbrojtës) të sistemit tetëshkallësh të integruar të mbrojtjes nga mbingarkesa" iu ndanë çmimet në vijim:

- **Medalje e argjendtë** nga juria profesionale e "IENA 2011";
- **Medalje e argjendtë** me diplomë nga Shoqata e shpikësve të Republikës së Polonisë;

Shpikësve Ismail Asani dhe Xhelal Aliu për shpikjen : "Kazan elektrik për ngrohje ajrore" iu ndanë çmimet në vijim:

- **Medalje me diplomë** nga Enti për patenta i Turqisë;
- **Çmim special** nga Shoqata për promovimin e inovacioneve të Republikës së Koresë.

Shpikësit Donço Ançovski për shpikjen "Përzjerje piroteknike për rregullimin e reshjeve" iu nda çmimi në vijim:

- **Medalje dhe diplomë** nga shoqata e Asociacionit për bashkëpunim shkencor dhe teknologjik të Ruisisë;

Shpikësit Vladimir Jaqovski për shpikjen "Pajisje për shfrytëzim optimal të materialeve dhe energjisë" iu nda çmimi në vijim:

- **Çmim special** nga Instituti i parë për shpikës dhe hulumtues i Republikës Islamike të Iranit;

Enti shtetëror për pronësi industriale për pjesëmarrjen e tij dhe kontributin aktiv në promovimin e inovacioneve mori diplomë nga Enti për patenta i Turqisë.

IX PËRFAQËSUESIT

Në vitin 2011 u organizua provim profesional për përfaqësuesit e të drejtave të pronësisë industriale. Provimin e kaluan 23 persona. Me këtë numri i përgjithshëm i personave që kanë kaluar provimin profesional për përfaqësues respektivisht persona të cilëve u njihet provimi i specializuar sipas evidencës që mban Enti shtetëror për pronësi industriale është 404.

Në regjistër të përfaqësuesve u regjistruan 4 përfaqësues të ri, ndërsa u shlyen gjithsej 4 përfaqësues.

X PUNË TË PËRGJITHSHME

Revizioni i brendshëm

Në departamentin e revizionit të brendshëm të Entit shtetëror për pronësi industriale janë realizuar obligimet nga Plani i punës për vitin 2011. Kështu janë kryer këto aktivitete:

- Revizion në fushën "Cikli buxhetor" me theks të veçantë në revizionin e procesit "planifikimi dhe shpenzimi i mjeteve financiare" në përputhje me planin vjetor financiar për vitin 2010 dhe tre muajt e parë të vitit 2011, për çka u përgatit edhe raport i revizionit;
- Revizioni në fushën "Procesi i furnizimeve dhe pagesave" me revizion të procesit "pranim kuantitativ dhe kualitativ i të mirave dhe shërbimeve" për çka u përgatit edhe raport revizioni;

- Revizion në fushën “Proces i furnizimeve dhe pagesave”, me theks të veçantë në procesin “mbulimi ligjor i obligimeve ndaj furnizuesve”, që ka të bëjë me materiale të dorëzuara dhe shërbime të ofruara për vitin 2009, vitin 2010 dhe gjashtë muajt e parë të vitit 2011, për çka u përgatit edhe raport revizioni;
- Janë plotësuar formularët në lidhje me “Planin aksional të ESHPI për vitin 2012” dhe janë dhënë përgjigje për materialin: “Strategjia e konceptit të JVFK të Republikës së Maqedonisë”;
- Është realizuar revizion i jashtëzakonshëm për punën materiale – financiare të ESHPI në periudhën 01.09.2009 deri më 31.12.2010 dhe për të njëjtën është përgatitur raport adekuat revizioni.

Mbështetja e IT-së

Enti shtetëror për pronësi industriale disponon me baza të veta të të dhënave për të drejta të paraqitura dhe të mbrojtura të pronësisë industriale (patenta, marka tregtare, dizajn industrial dhe emërtime gjeografike). Për përpunimin e tyre përdoret programi IPAS - Industrial property Administration System që është platformë e zhvilluar nga Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale (WIPO) që shërben për menaxhimin e dokumenteve të përdoruesve. Vetë IPAS është klient – server platformë e zhvilluar në të ashtuquajturën teknologji Centura, që mundëson që IPAS administrativ dhe ai i klientit të komunikojnë me bazën e të dhënave që është në platformë Oracle, ku ruhen të gjitha të dhënat.

Punët administrative të ESHPI në departamentin për pranim dhe përpunim të dokumenteve për arritjen e së drejtës për pronësi industriale dhe në departamentin për arkivim të përgjithshëm përdoret program me bazë Lotus Notes që është softuer aplikativ, platformë e zhvilluar nga IBM dhe është platformë klient server që përdoret për shërbimet në vijim:

- Postë elektronike (e-mail),
- Ueb-server, ku është postuar ueb-faqja e ESHPI dhe aplikacioni për administrimin e ueb-faqes,
- Softuer për punë të arkivit me regjistratorë dhe libër amë.

Punët financiare

Obligimet nga fusha e punëve financiare i kryejnë të punësuarit në Shërbimin për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Gjatë vitit 2011 janë kryer të gjitha obligimet në lidhje me punët e kontabilitetit të Entit (përgatitja e buxhetit, plane vjetore dhe tremujore, pasqyra për detyrime të papaguara në fund të çdo muaji të kaluar, informacione të hershme me kërkesë të personit përgjegjës të Entit dhe Ministrisë së financave dhe Sekretarit gjeneral pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, përgatitjen e rrogave, përlogaritjes vjetore, regjistrimit të mjeteve themelore, raporte statistikore dhe Raport Vjetor Tatimor).